ASPIRIN (acid acetilsalicilik, ASA) **81 mg**

Acidi acetilsalicilik është antiinflamator josteroid, me efekte antiinflamatore, analgjezike antipiretike, dhe antiagregant

Është indikuar për lehtësimin e dhimbjeve, ethes dhe inflamacionit në një shumëllojshmëri sëmundjesh të tilla si gripi, ftohje, dhembje e qafes dhe e shpinës, dysmenorhea, dhimbje koke, dhimbje dhembi, ndrydhje e kyçit dhe tendosje, fraktura, miozit, neuralgji, sinoviti, artrit, bursit, djegiet, lëndime dhe pas procedurave kirurgjike dhe dentare.

Redukton riskun e vdekshmërisë në pacientët me suspekt IAM infarkt akut miokardi.

Redukton riskun e një infakti akut miokardit të parë jo fatal të pacientët që kanë të gjithë faktorët e riskut. (Nuk ka të dhëna për reduktimin e riskut të IAM fatal të parë.) Rënia e riskut të një infarkti akut të miokardi të parë jo fatal, duhet vlerësuar në lidhje me riskun e vogël por jo sinjifikant për hemorragji në traktin gastro-intestinal

Redukton riskun e sëmundshmërisë dhe vdekjes në pacientët me angina pektoris të paqëndrueshme dhe në pacientët që kanë kaluar IAM.

Redukton riskun e atakut ishemik tranzitor (ITA) dhe për parandalim sekondar ndaj infarktit cerebral atero-trombotik

Profilaksi për tromembolizmin venoz pas vendosjes së protezës së artikulacionit coxo-femoral.

Reduktim i adezionit trombocitar pas endarterektomisë trombocitare në parandalimin e TIA, në pacientët në hemodializë dhe me një kanjulë arterio-venoze.

Kundërindikacionet:

Pacientët me ndjeshmëri të lartë ndaj salicilateve, antiinflamatorëve jo steroidë, analgjezikë, antipiretikëve dhe ndaj përbërësve të tjerë:

- Ulçera gasto-intestinale

- Diateza hemorragjike
- Insuficencë hepatike akute ose severe, insuficiençë renale, insuficiençë hepatike, cirrozë
- Pacientë me histori sëmundje, astme nga administrimi i salicilateve ose antiinflamatoreve të tjerë jo steroid.
- Kombinimi me metotrexate 15mg/jave ose më tepër
- Trimestri i fundit i shtatzënisë.
- Femijët më të vegjël se 12 vjec. Rreziku i Sindromit Reye, encefalopatisë hepatike, në rast të simptomave gripale te fëmijët të shkaktuar nga influenzavirus A, B, varicela administrimi I ASA.
- Eskretim të ulët të acidit urik.
- Deficençë e G6PD, glukoz 6 fosfat dehirogjenazës.

Efektet anësore:

Trakti gastrointestinal(efekte dozë-vartëse): nauze, të vjella, diarre, hemorragji gastrointestinal/ulcer, dispepsi, pirozë, hematemeze, melena, dhimbje abdominal.

Gjakrrjedhje:epistaksis, hematomeza, gjakrrjedhje gingivale.hemorragji të rëndësishme në traktin gastrointestinal, cerebrale.

Vesh: marrje mendsh, tinitus, rënie dëgjimi. Mund të indikojnë overdozë, këto simptoma.

Hematologjike: leucopenia, trombocitopenia, purpura, anemi.

***Ndërveprime midis medikamenteve*:**

Methotrexate, Anti-trombotilike, antikoagulante, hipoglicemiante oralë, diuretike, digoxine etj.

Përdorimi:

Terapi ditore

- Parandalim i atakut kardiak jo-fatal të parë te pacientë me factor risku.
- Parandalim i IAM, stroke në pacientët që kanë kaluar IAM më parë.

Gjatë një ataku kardiak IAM, një anginë pectoris e paqëndrueshme, kur pacienti ka një dhimbje të madhe në gjaks që përhapet në krahëror lartë në noull, në shpatull, që zgjat disa minuta, ka kokëlehtësim, djersitje, marrje fryme.